



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:177814

Datë: 02.09.2024

Numri i dokumentit: 06110765

PKR.nr.165/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - Departamenti i Krimeve të Rënda, Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari Gazmend Bahtiri, me bashkëpunëtoren profesionale Albana Curri dhe procesmbajtësen Dalina Kërqeli - Abdullahu - zyrtare ligjore, në çështjen penale kundër të akuzuarve M.S. dhe Sh.S., për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Sulmi nga neni 184 paragrafi 1, lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme KPRK), të akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, nën shenjën PP.I.nr.419/2021, të datës 07.04.2023, e parashtruar në gjykatë me datë 12.04.2023, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar - publik, me datë 08.08.2024, në prezencën e Prokurores së shtetit F.C., të pandehurit Sh. S., me mbrojtësin e tij sipas detyrës zyrtare avokat N. R., të akuzuarit M.S. me mbrojtësin e tij sipas autorizimit avokat M. H., të akuzuarit Sh. S., si dhe të dëmtuari – dëshmitarit B. B., po të njëjtën datë (08.08.2024) mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 02.09.2024, përpiloj këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1. M. S., nga i ati R. dhe e ëma V. (e lindur T.) e lindur me datë, në P., ku edhe jeton, me adresë rruga “X. M.”, pa numër, me numër personal të identifikimit, të lëshuar nga MPB e Republikës së Kosovës, i martuar, baba i dy fëmijëve, ka të përfunduar tre klasë të shkollës fillore, merret me prerjen e drunjëve kohë pas kohe, i gjendjes së dobët ekonomike (rast social), Ashkali - Shtetas i Republikës së Kosovës.

2. SH.S., nga i ati R. dhe e ëma V. (e lindur T.) e lindur me datë ..., në P..., ku edhe jeton, me adresë rruga “Xh. M.”, pa numër, me numër personal të identifikimit ..., të lëshuar nga MPB e Republikës së Kosovës, i pa martuar, ka të përfunduar pesë klasë të shkollës fillore, merret me prerjen e drunjëve kohë pas kohe, i gjendjes së dobët ekonomike (rast social), Ashkali - Shtetas i Republikës së Kosovës.

J A N Ë F A J T O R Ë

Sepse:

Më datë 12.06.2021, rreth orës 14:30/h, në hapësirën e S. të A., që gjendet në rr. “Z. P.” në P., të pandehurit M. e Sh. S., me dashje që të i shkaktojnë lëndime trupore tani të dëmtuarit B. B., për shkak të takimit që i njëjti kishte lënë me motrën e tyre, e sulmojnë të dëmtuarin duke e goditur me shuplaka dhe boksa në pjesë të ndryshme të trupit.

Me këtë në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Sulmi nga neni 184 paragrafi 1, lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të neneve 1, 2, 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 31, 38, 39, 46, 47, 48, 49, 69, 70, lidhur me nenin 184 paragrafi 1, nenin 31 të KPRK-së, si dhe neneve 358, 360, 361, 364, 365, 368, 369, 449 dhe 452, të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (tutje KPPRK) të akuzuarit i:

G J Y K O N

ME DËNIM ME KUSHT ashtu që secilit veç e veç iu shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej tre (3) muajve, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen, nëse në periudhën e verifikimit prej një (1) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, të akuzuarit e lartpërmendur nuk kryejnë ndonjë vepër tjetër penale.

Kërkesë pasurore juridike nga ana e palës së dëmtuar nuk kishte.

DETYROHEN të akuzuarit (secili veç e veç) që në emër të shpenzimeve të procedurës penale - paushallit gjyqësor, të e paguajnë shumën prej 20,00 (njëzet) euro dhe në emër të taksës për Fondin e Kompensimin e Viktimave të Krimit, shumën prej 50,00 (pesëdhjetë) euro, e gjitha këto në afatin prej 15 ditëve, nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.

A r s y e t i m

Aktakuza

Prokuroria Themelore Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda, fillimisht ka ngritur aktakuzën me shenjën PP.I.nr.419/2021, të datës 07.04.2023, e pranuar në gjykatë me datë 12.04.2023, kundër të pandehurit Sh. S. për veprën penale Grabitja nga neni 317 paragrafi 1 të KPRK-së dhe të akuzuarve M.S. dhe Sh.S. për veprën penale Sulmi nga neni 184 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Kompetenca e gjykatës

Gjykata para se të caktoj shqyrtimin fillestar, në vështrimin e aktakuzës ka vlerësuar sipas detyrës zyrtare çështjen e kompetencës territoriale dhe të asaj lëndore. Sa i përket kompetencës territoriale gjykata vlerëson se në kuptim të nenit 29 paragrafi 1 i KPPRK-së, kompetencë territoriale për t'u gjykuar një çështje juridiko-penale, ka gjykata në territorin e së cilës është kryer apo është tentuar të kryhet vepra penale, apo në territorin e së cilës është shkaktuar pasoja. Në rastin konkret vepra penale për të cilën janë akuzuar M.S. dhe Sh. S., ka të bëjë me territorin e Prishtinës – adresa: rruga “Z. P.” në P., andaj Gjykata Themelore në Prishtinë, ka kompetencën territoriale në gjykimin e kësaj çështje.

Duke vlerësuar kompetencën lëndore, gjykata konstaton se veprat penale, të cilat nga organi i akuzës fillimisht i janë vënë në barrë të te akuzuarve M.S. dhe Sh. S., përkatësisht Grabitja nga neni 317 paragrafi 1 të KPRK-së, është përcaktuar si krim i rëndë me nenin 22 të KPPRK-së, gjykata konstaton se Departamenti për Krime të Rënda, ka kompetencën lëndore për gjykimin e kësaj çështje.

Shqyrtimi fillestar

Gjykata pasi që fillimisht kishte vlerësuar kompetencën, si dhe ka vlerësuar të metat formale dhe juridike të aktakuzës, duke vepruar sipas kësaj çështjeje penale, me datë 08.08.2024 ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar, në të cilin kanë prezantuar të gjitha palët në procedurë.

I pandehuri Sh. S., nuk e kishte pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, ashtu që Prokurori i shtetit i kishte propozuar gjykatës që të veçohet procedura penale lidhur me të pandehurin në fjalë, pasi që i njëjti në seancën e shqyrtimit fillestar, nuk e ka pranuar fajësinë, me propozim për gjykatën që të zhvillohet procedura ndaras. Mbrojtësi i të pandehurit sipas detyrës zyrtare N.R., avokat në P., në rastin konkret ishte pajtuar që të veçohet procedura ndaj të njëjtit.

Të akuzuarit M.S. dhe Sh. S., e kishin pranuar fajësinë në raport me veprën penale që iu është vënë në barrë nga organi i akuzës.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve M.S. dhe Sh.S. për veprën penale Sulmi nga neni 184 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ishte deklaruar si vijon: pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve është në përputhshmëri të plotë me dispozitat ligjore të KPPRK-së, lidhur me pranimin e fajësisë, gjithashtu pranimi i fajësisë nga ana e tyre mbështetet në provat e mjaftueshme dhe të ligjshme që i përmban kjo aktakuzë, me propozim për gjykatën që të e miratojë pranimin e fajësisë nga të akuzuarit e lartpërmendur për veprën penale si në aktakuzë, të njëjtit t'i shpall fajtor, t'i dënojë sipas ligjit dhe në rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit t'i merr parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara me ligj me qëllim të një vendimi të drejtë.

Mbrojtësi i të pandehurit M.S., avokat M. H., lidhur me pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i tij ishte deklaruar si vijon: pasi që i mbrojturi im e pranojë fajësinë dhe është i gjendjes së dobët ekonomike, është rast social dhe deri më tani nuk ka pasur të kaluar kriminale, i kërkoj falje palës së dëmtuar dhe me të njëjtin janë rregulluar në baza familjare, duke kërkuar nga gjykata që në rastin e caktimit të dënimit të njëjtit t'i caktojë një dënim sa më të butë por në suaza ligjore.

I dëmtuari B. B. lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve M.S. dhe Sh. S. ishte deklaruar si vijon: nuk i bashkëngjitem ndjekjes penale, nuk kërkojë kompensim dëmi sepse

më është kthyer kuleta me gjysmën e parave, ndërsa të nesërmen pjesën tjetër të parave mi ka dhënë babai i M.S. dhe Sh.S.

Kryetari i trupit gjykues – gjyqtari, ka vlerësuar se të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga të njëjtit, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër, si dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike.

Gjykata pas pranimit të fajësisë nga të akuzuarit, si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit, të dëmtuarit, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, ka vlerësuar se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës ligjore nga neni 242 paragrafi 1 dhe 2 të KPPRK-së, duke e aprovuar pranimin e fajësisë nga të akuzuarit në shqyrtimin fillestar, andaj konform nenit 242 paragrafi 6 të KPPRK-së, ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Vlerësimi i gjykatës lidhur me elementet e veprave penale

Gjykata ka vlerësuar format e kryerjes së veprës penale Sulmi nga neni 184 paragrafi 1 të KPRK-së, me të cilën dispozitë është përcaktuar se: “Kushdo që me dashje përdor forcën ndaj personit tjetër, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit”, ndërsa dispozita ligjore e nenit 31, të Kodit të lartcekur, ka përcaktuar se: “Nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për veprën penale”. Në rastin konkret dy të akuzuarit M.S. dhe Sh.S., bashkërisht i kanë kontribuar veprës penale që i ngarkon aktakuza, ngase të njëjtit duke e përdorur forcën e tyre ndaj palës së dëmtuar B. B., e kanë goditur të njëjtin në pjesë të ndryshme të trupit, e që gjykata konstaton se në tërësi janë përmbushur të gjitha elementet e veprës penale Sulmi nga neni 184 paragrafi 1, lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të sanksionit penal

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 73 dhe 74 të KPRK-së dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti

faktin se të akuzuarit në shqyrtimin fillestar e kanë pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila iu vihet në barrë, ashtu që fakti se të njëjtit e kanë pranuar fajësinë duke shprehur pendesë, tregon se ndjehen përgjegjës për veprimet e tyre lidhur me rastin konkret, çka tregon nivel të ndërgjegjësimit të te kuptuarit dhe reflektimit mbi sjelljet e tyre në të ardhmen. Të njëjtit e kanë bërë kompensimin e dëmit që i është shkaktuar palës së dëmtuar, si dhe faktin tjetër se të akuzuarit kanë gjendje jo të mirë financiare ekonomike.

Si rrethana rënduese për të akuzuarit, gjykata ka gjetur shkallën e përgjegjësisë penale të tyre të kryer me dashje direkte dhe paramendim, si dhe faktin tjetër se të njëjtit edhe më parë kanë rënë ndesh me ligjin, e këtë bazuar sipas vendimeve dënuese dhe atë: I akuzuari M.S. është gjykuar me vendim të formës së prerë nga Gjykata Themelore Prishtinë – Dega në Podujevë, numri i lëndës: P.nr.499/2020, datë 29.01.2021, për shkak të veprës penale Vjedhja në tentativë nga neni 313 paragrafi 1, lidhur me nenin 31 të KPRK-së, i gjykuar me dënim me kusht, si dhe dënim me gjobë në shumën prej 200,00 (dyqind euro), ndërsa i akuzuari Sh. S. është gjykuar me vendim të formës së prerë nga Gjykata Themelore Prishtinë – Dega në Podujevë, numri i lëndës: P.nr.355/2023, datë 14.09.2023, për shkak të veprës penale Kanosja nga neni 181 paragrafi 1 të KPRK-së, i gjykuar me dënim me kusht, vendime këto të cilat janë siguruar nga Sistemi i evidencës penale të kësaj gjykate, e të cilat janë pjesë përbërëse e shkresave të lëndës.

Në rastin konkret gjykata vlerëson se dënimi i shqiptuar si në dispozitiv të aktgjykimit është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen e kryerësve, me rrethanat e kryerjes, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, si dhe me përgjegjësinë e kryerësve. Sipas bindjes së gjykatës, ky dënim përveç që do të mundësoj risocializimin dhe riedukimin e tyre, i njëjti do të ndikoj edhe tek tjerët që të mos kryejnë vepra penale, gjegjësisht do të ndihmoj në ngritjen e vetëdijes së përgjithshme lidhur me detyrimin për respektimin e ligjit, i cili është edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së.

Vendimi lidhur me veçimin e procedurës në raport me të pandehurit Sh.S.

Gjykata me aktvendim të veçantë të evidentuar nën shenjën PKR.nr.165/23, të datës 08.08.2024, e ka aprovuar propozimin e prokurorit të shtetit (pas marrjes së mendimit nga ana e mbrojtësve të te akuzuarve M.H. dhe N. R. që të dy avokat në P.), ashtu që në rastin konkret e ka bërë veçimin e procedurës kundër të pandehurit Sh. S. për shkak të veprës penale Grabitja nga neni 317 paragrafi 1 të KPRK-së, e këtë bazuar në nenin 35, paragrafi 1, 2, 3 dhe 4 të

KPPRK-së, ku është përcaktuar se: “Gjykata e cila sipas këtij Kodi është kompetente, për shkaqe të rëndësishme ose për arsye të efikasitetit, deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor mund të vendos veçimin e procedurave të zbatuara për disa vepra penale ose kundër disa të pandehurve dhe të procedojë ndaras ose çështjet e ndara ia dërgon një gjykate tjetër kompetente. Aktvendimin për veçimin e procedurës e merr gjykata kompetente pas dëgjimit të palëve dhe mbrojtësit. Kundër aktvendimit me të cilin lejohet veçimi i procedurës ose refuzimi i propozimit për veçimin e procedurës nuk lejohet ankesë. Deri në ngritje të aktakuzës, prokurori kompetent i shtetit ka kompetencë që ta bëjë veçimin e procedurës”.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike

Meqenëse i dëmtuari B.B. në seancën e shqyrtimit fillestar nuk kishte kërkuar kompensim dëmi, ngase të njëjtit i është kompensuar dëmi nga të akuzuarit dhe prindi i tyre, gjykata të njëjtin nuk e ka udhëzuar në kontest të rregullt juridiko – civil.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 449 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.6, lidhur me nenin 452 paragrafi 1 të KPPRK-së, ndërsa vendimi në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marrë, konform nenit 36 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 të Ligjit nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 364 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Departamenti i Krimeve të Rënda

PKR.nr.165/23, datë 02.09.2024

Zyrtare ligjore,
Dalina Kërqeli - Abdullahu

Kryetari i trupit gjykues – gjyqtari,
Gazmend Bahtiri

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej tridhjetë (30) ditëve, nga dita e pranimi, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në ekzemplarë të mjaftueshëm për gjykatën dhe palët.